



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:146145  
Datë: 17.06.2021  
Numri i dokumentit: 01897888

P.nr.903/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A. T. nga Gjilani për shkak të veprës prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimor nga neni 261 paragrafi 1 i KPRK-ës, të cilin sipas autorizimit e mbron avokati Mustafë Nuhiu nga Gjilani duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.1846/2020, të datës 11.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, me datë 11.06.2021 morri dhe shpalli ndërsa me datë 17.06.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A. T., nga babai S. dhe nëna H., e lindur Th., i lindur me datë 23.03.1984 në Gjilan ku edhe jeton në lagjen “Dardania I”, rruga: “.....”, numër 85, ka të kryer Fakultetin Ekonomik, i martuar, baba i 2 fëmijëve, i pa punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 29.10.2020, rreth orës 09:45 minuta, në Gjilan, në depon “TasKos”, me rastin e kontrollimit inspektorët e tregut dhe zyrtarët policor kanë hasur në artikuj të dëmshëm ushqimor dhe higjienik dhe atë: Crispy Tiks 71 pako, Toni Chips 3 pako me afat të skadimit 20.08.2020, Frozen Suprise 259 copë me afat të skadimit të vitit 2019, Spider Man Boy 103 copë, Flips 200 gram 10x50 copë me afat të skaduar me datë 30.12.2019, Fruit-Jup me afat të skaduar me datë 12.04.2018 103x50 gram, Power Gum me afat të skaduar në muajin gusht të vitit 2016 60 pako nga copë, Power Green me afat të skaduar në muajin gusht të vitit 2016 60 pako nga copë, Twins Cup me afat të skaduar në muajin mars të vitit 2020 60x50 gram për të cilat i akuzuari e ka ditur se janë me afat të skaduar dhe mallra të tjera të cilat janë mbajtur dhe ruajtur në kushte të papërshtatshme për të cilat nuk ka pasur mbulesë për prejardhjen e tyre me ç’rast i akuzuari me mallra me afat të skaduar ka rrezikuar shëndetin e njerëzve.

-Me çka ka kryer veprën penale prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimor nga neni 261 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,43,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 dhe 365 të KPP-ës të akuzuarin A. T.:

## E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 1500 € (njëmijepesëqind euro) të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 2 muajve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

Në bazë të nenit 79 të KPRK-ës koha e kaluar nën masën arrestit shtëpiak nga data 29.10.2020 deri me datë 16.11.2020 do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë.

Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

## ARSYETIM

### 1.Rrjedha e çështjes dhe fjalët përfundimtare të palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 11.11.2020 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1846/2020 kundër të akuzuarit A. T., nga Gjilani, për shkak të veprës prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimor nga neni 261 paragrafi 1 i KPRK-ës ndërsa me krijimin e kushteve ligjore gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor në të cilat është bërë administrimi i provave si dhe palët kanë dhënë fjalët e tyre përfundimtare.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë procedimit të provave në shqyrtim gjyqësor prokuroria konsideron se është vërtetuar në tërësi përtej dyshimit të bazuar se vepra penale prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimor nga neni 261 paragrafi 1 i KPRK-së është kryer dhe pikërisht i akuzuari A. T. është kryerës i saj gjithnjë duke u bazuar në provat personale dhe materiale dhe atë nga deklaratat e dëshmitarëve Sh. S., A. K., J. S. të cilët kanë qenë pjesë e kontrollit dhe bastisjes në lokalet e të akuzuarit dhe nga të njëjtët në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar se tek i akuzuari është gjetur mall me afat të skaduar nga viti 2016 e deri në vitin 2020 gjithashtu është gjetur mall i cili ka qenë duke u mbajtur në ambiente të papërshtatshme dhe ky mall ka qenë i dedikuar për shitje apo për tu vënë në qarkullim. Se tek i akuzuari është gjetur mall me afat të skaduar dhe mall me afat i

ruajtur në kushtet të papërshtatshme duke iu ekspozuar kushteve të ndryshme klimatike dhe si i tillë i dëmshëm për shëndetin e njerëzve është provuar edhe nga dëshmitarja G. S. sikurse edhe nga dëshmitarja A. F. eksperte të kësaj lëmie të cilat kanë deklaruar se ky mall nuk ka guxuar të vihet në qarkullim e as të ruhet me afat të skaduar dhe si i tillë më pas është asgjësuar. Një fakt i tillë është vërtetuar edhe nga vetë deklarata e të akuzuarit përkundër se i njëjti ka provuar që të shmang përgjegjësin nga vetja dhe ti minimizoj veprimet e veta se kinse malli ka pasur për tu kthyer dhe prodhuesi nuk ka pasur mall të tillë t'ia zëvendësoj dhe të njëjtit "iu është dhimbsur ta gjuaj", që pa mëdyshje e vërteton faktin se i njëjti e ka ruajtur mallin për qëllime të tjera për shitje apo edhe për ta vënë në qarkullim në ndonjë formë tjetër zëvendësimi, se malli është ruajtur në kushte të pa përshtatshme dhe si i tillë është vënë në qarkullim është vërtetuar edhe nga deklarata e të akuzuarit ngase i njëjti gjatë shqyrtimit gjyqësor vetë e ka pohuar se ka pasur mall që e ka ruajtur nën strehë apo si e quan ai nën një mbulojë të një terase që pa mëdyshje ishte hapur dhe në këto rrethana iu është ekspozuar kushteve klimatike që mallit ia hupin vlerat dhe përmbajtjen e po ashtu është i dëmshëm edhe për shëndetin përkundër se i akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor theksoj se malli i skaduar dhe i gjetur tek i njëjti ka pasur "për ta kthyer" i njëjti me asnjë dëshmi nuk e vërtetoi këtë thënie të tij, përkundër edhe kërkesave të inspekteve që tu paraqes faturat apo edhe kërkesës sonë që të paraqes ndonjë procesverbal për kthimin apo zëvendësimin e mallit çka do të thotë se i akuzuarit ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e tija dhe ka vepruar me dashje e po ashtu ka pasur qëllim përfitimi, se është kryer kjo veprë penale në mënyrë të pa kontestueshme është vërtetuar edhe nga provat materiale të cilat janë administruar gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor andaj i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale që ia vë në barrë aktakuza dhe ti jepet një dënim meritor sipas ligjit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e që në rastin konkret konsideron se nuk ka asnjë rrethana lehtësuese.

Mbrojtësi i të akuzuarit, avokati Mustafë Nuhiu në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e shqyrtuara në shqyrtim gjyqësor lidhur me faktet të cilat është mbështetur aktakuza konsideron se me asnjë provë personale dhe materiale nuk është provuar se i akuzuarit ka kryer veprën penale prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimorë nga neni 261 paragrafi 1 i KPRK-së, në aktin akuzues dhe nga të gjitha provat personale dhe materiale është theksuar se tek i akuzuarit është gjetur dhe ruajtur mall me afat të skaduar dhe në kushte të papërshtatshme, nuk ka pasur mbulesë për prejardhjen e këtij malli dhe se i akuzuarit ka rrezikuar shëndetin e njerëzve, pra ky dispozitiv i aktakuzës është në tërësi në kundërshtim me kualifikimin e veprës penale të pretenduar nga prokuroria e shtetit, lidhur me figurën e veprës penale që përmban kjo dispozitë se i akuzuarit ka prodhuar artikuj ushqimorë dhe me afat të skaduar nga provat e administruara nuk është gjetur se i njëjti ka prodhuar artikujt e lartcekur dhe ka vënë në qarkullim artikuj ushqimorë dhe po ashtu i njëjti nuk ka vënë në rrezik jetën e qytetarëve. Artikujt ushqimorë me afat të skaduar janë gjetur në depon e të akuzuarit me qëllim që i njëjti ti kthej tek prodhuesit përkatës po ashtu është vërtetuar se artikujt me afat të skaduar në depon e tij kanë qenë të ruajtur dhe të paketuar në pjesë të veçantë të kësaj depoje, po ashtu nga prokuroria nuk është provuar se ky mall me afat të skaduar iu është shitur ndonjë palepersonit të dëmtuar eventual andaj nga të lartcekurat duke theksuar edhe një herë se i akuzuarit nuk ka prodhuar mallin, nuk ka vënë në qarkullim dhe nuk ka dëmtuar askënd në kuptim të nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së i ka propozuar gjykatës që të marrë aktgjykim

lirues për faktin se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari A. T. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe ka shtuar se ky mall pa afat asnjëherë nuk ka qenë në qarkullim pra nuk është vërtetuar se ky mall ka qenë në shitje apo ka qenë për shitje, kjo nuk është vërtetuar as nga inspekcioni dhe ky mall nuk ishte në shitje as një pikë shitës, se ndihet i pa fajshëm dhe se nuk e ka kryer këtë veprë penale dhe nuk ka shitur mall pa afat dhe as nuk ka menduar për të shitur ndonjë herë dhe nëse vërtetohet që ai ka kryer këtë veprë penale të dënohet me dënimin më të madh.

## 2. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit është vërtetuar pas administrimit të provave personale dhe materiale dhe atë:

- Dëgjimit të dëshmitares A. F.,
- Dëgjimit të dëshmitares G. S.,
- Dëgjimit të dëshmitarit Sh. S.,
- Dëgjimit të dëshmitarit A. K.,
- Dëgjimit të dëshmitarit J. S.,
- Leximin e provave materiale dhe atë : Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2020-KE-133 i datës 29.10.2020, procesverbali mbi kontrollin e lokalit të datës 26.10.2020, procesverbalet mbi inspektimin të bëra nga Drejtoria e Inspekcionit përkatësisht Inspekcioni i Tregut me numër 14/1054 i datës 29.10.2020 dhe numra serik 001052, 001053 dhe 001054, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, të dhënat nga ARBK për kompaninë NTP ‘‘TosKos’’, raporti i hetuesit i datë 29.10.2020, deklarata e të akuzuarit e dhëne në polici me datë 29.10.2020, deklarata e të akuzuarit e dhënë në prokurori me datë 09.11.2020 si dhe
- Mbrojtjes së të akuzuarit Arbër Toska.

### 2.1. Deklarata e dëshmitares A. F.

Dëshmitarja A. F. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se është e vërtetë se ajo me datë 29.10.2020 e ka nënshkruar raportin të cilin e ka hartuar kolegja e saj dhe se përmbajtja e këtij raporti është e vërtetë. Në depo kanë shkuar me kërkesën e policisë dhe me urdhër të drejtorit të inspektoratit, kanë gjetur mallin me afat të skaduar dhe të cilat kanë qenë te ruajtura në kushte të papërshtatshme për ato mallra, kanë konstatuar se malli është i skaduar në baze të deklaratës se vetë prodhuesit dhe se është e vërtetë se në depo ka pas mallra me afat të skaduar nga viti 2019, 2018 të cilat janë shënuar edhe në procesverbal. Malli të cilit i skadon afati nuk guxon të hyj në treg sepse një gjë e tillë është e përcaktuar edhe me ligjin mbi ushqimin. Prodhuesi i përcakton kushtet e ruajtjes së produktit ndërsa këto mallra nuk janë ruajtur në kushte të përshtatshme sepse nuk është dashur të ruhen në ambient të jashtëm ngase përveç temperaturave të njëjtat rrezikohen edhe nga brejtësit dhe nga gjerat e tjera. Mallin e kanë konfiskuar dhe asgjësuar si të papërshtatshëm për konsumim publik. Mallin e sekuestruar e

kanë gjetur gjet në një vend të cilin nuk do ta kishte quajtur depo por garazh dhe oborr, garazhi ka pasur mbulojë për ta ruajtur mallin nga shiu, breshëri, drita dhe dielli mirëpo garazhi nuk është i përcaktuar për vendosjen e mallit kurse në depo ushqimore janë kushte tjera të përcaktuara me ligjin mbi ushqimin. Çdo produkt e ka të shënuar në tiketë temperaturën dhe kushtet e ruajtjes dhe nëse nuk i përmbahemi këtyre kushteve ai mall është mall i dyshimte për konsum dhe në rastin konkret në procesverbal kanë konstatuar se kushtet e mallit nuk janë të përshtatshme. Në krahasim me mallin e ekspozuar jashtë shitoreve të vogla në raste të tilla u kanë shqiptuar vërejtje, dënime dhe kanë bërë edhe kallëzime penale në rastet kur shitësit nuk u janë përmbajtur kushteve. Ajo nuk ka ndonjë informacion nëse ndonjë qytetar ka pësuar si pasojë e konsumit të mallit të A. T. mirëpo këto inspektive i bëjmë si mase parandaluese në të gjitha rastet kur hasim në mall me afat të skaduar dhe procedura është e njejtë. E njëjta ka deklaruar po ashtu se është e vërtetë se në këtë garazh ka pas edhe mallra të tjera si detergjente etj, në këtë garazh ka pasur edhe raftet ku disa mallra kanë qenë të vendosura në to ndërsa disa mallra në paketa dhe se sipas perceptimit të saj ato mallra kanë qenë të ekspozuara për tu shitur e jo për konsum individual dhe se kushtet në të cilat është mbajtur ky mall nuk kanë qenë në harmoni me ligjin mbi ushqimit dhe vet kushtet të cilat i përcakton prodhuesi i atij ushqimi.

## 2.2 Deklarata e dëshmitares A. F.

Dëshmitarja A. F. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se është e vërtetë se ajo ka qenë prezent me rastin e inspektimit të shtëpisë së të akuzuarit ku pas njoftimit nga ana e policisë kanë shkuar në shtëpia e të akuzuarit por edhe objektet përcjellëse policia u kanë thënë se këtu dyshojnë se ka mall pa afat, pastaj kishte ardhur i akuzuari e kishte hapur garazhin dhe brenda kishte pasur mall pa afat, siç ishin produkte ushqimore për fëmijë, në oborr kishte pasur mall me afat i cili nuk ishte ruajtur sipas kushteve të ruajtjes të cilat i përcakton ligji për ushqimin sepse i njëjti mall ishte në ambient të hapur, se pari e kanë fotografuar mallin dhe kanë përpiluar procesin pastaj e kanë asgjësuar mallin tek kompania “Eco Higjena”, biznesi i të akuzuarit është i regjistruar dhe bazuar në këtë malli i gjetur tek ai ka qenë i dedikuar për shitje, në garazh ka pasur mallra që në vitin 2016 iu kishte skaduar afati dhe si të tilla nëse të njëjtat shiten apo konsumohen janë të dëmshme për shëndetin e njeriut, malli i gjetur në ambient të hapur-oborrit e të akuzuarit në kushtet të cilat ka qenë edhe ai ka përbërë rrezik për shëndetin e njeriut sepse çdo prodhues i mallit përcakton kushtet e ruajtjes së tij, të cilat kushte janë të shkruara në etiketat të bashkangjitura në ambalazh. Në Ligjin për Ushqimin përkatësisht në nenin 20 pika 4.5, 4.6, 4.7 përcaktohen kushtet për ruajtjen e ushqimit dhe në rastin konkret malli i gjetur tek i akuzuari ka qenë në kundërshtim me këtë ligj, po ashtu ka deklaruar se tek garazhi i të akuzuarit ka pasur mall me afat si p.sh detergjent, shampun të duarve por të njëjtat inspekcioni nuk i ka prekur sepse kanë pasur afat dhe kanë mund të ruhen edhe në ato kushte sipas ligjit të lartcekur dhe se me rastin e përpilimit të procesit e ka pyetur të akuzuarin se përse po e ruan këtë mall derisa i njëjti i ishte përgjigjur se e ruan për ta kthyer tek furnitori mirëpo i njëjti nuk kishte pasur dokumentacion për këtë mall duke shtuar se mallrat e gjetura pa afat – përkatësisht çamçakëzët pa afat kanë qenë të mbyllura dhe lidhur me këtë janë fotot të cila ia kanë bashkangjitur ku përshkruhen në mënyrë të saktë se si janë gjetur dhe si janë dukur.

### 2.3 Deklarata e dëshmitarit Sh. S.

Dëshmitari Sh. S. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se si njësi e krimeve ekonomike kanë pranuar një informacion se nga një depo ushqimore në lagjen “Dardania” në Gjilan me pronar A. T. i cili posedon dhe shpërndan mallra të ndryshme pa qenë të specifikuar se çfarë si dhe kanë vepruar menjëherë ku kanë njoftuar prokurorin e shtetit dhe ka qenë kërkesë e prokurorit të shtetit që të bastiset një depo dhe shtëpi me qëllim që të vërtetohet ky informacion apo dyshim dhe njësia e tyre së bashku me një ekip nga ATK-ja kanë kryer një kontroll tek një lloj i magazinës e cila ishte shfrytëzuar si depo dhe në të cilën kanë hasur disa artikuj të ndryshëm ushqimor dhe higjienik të cilat sipas inspekcioni komunal dhe njësisë sonë kanë qenë me afat të skaduar gjë që argumentohet edhe në bazë të procesverbalit nga inspektorët komunal, njëkohësisht nga inspektorët edhe ATK-ja mallra të cilat janë hasur nuk kanë pasur dokumentacion mbi prejardhjen e tyre dhe më pas inspektorët komunal dhe ata të ATK-ës kanë vazhduar me procedurën e tyre ligjore ndërsa i akuzuari ishte dërguar në stacionin policor dhe ishte intervistuar. Tutje i njëjti ka shtuar se kanë pasur informacion se i akuzuari posedon dhe shpërndan dhe se është duke ndërhyrë edhe në afatin e skadencës e që një fakt të tillë nuk kanë arrit ta vërtetojnë gjithashtu malli në depo ka qenë i renditur por kjo depo ka qenë garazh dhe nuk ka qenë e destinuar për depo sepse aty ka pasur edhe vegla të punës dhe sende të tjera, aty ka pasur edhe mallra me afat dhe beson se kjo është një arsye pse ato me afat nuk janë sekuestruar, por se nuk i kujtohet saktë nëse malli me afat të skaduar ka qenë i ndarë nga ai me afat por një gjë të tillë e ka verifikuar inspekcioni komunal. I njëjti po ashtu ka deklaruar se të akuzuarin e kanë zënë në flagrancë duke shpërndarë mall dhe se nuk kanë hasur në ndonjë makineri përmes të cilës ndërrohet afati i skadencës në mallra.

### 2.4 Deklarata e dëshmitarit A. F.

Dëshmitari A. F. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me datën siç është përshkruar në kallëzimin penal ai ka pranuar një informacion nga prokurorja e shtetit lidhur me dyshimet se një depo e cila gjendet në lagjen “Dardania” në Gjilan me pronar Arbër Toska bënë shpërndarjen e produkteve ushqimore me afat të skaduar dhe me të marrë këtë informacion ai ka dalë dhe ka bërë lokalizimin e kësaj depo dhe më pas e ka organizuar edhe njësitin e tij dhe së bashku me njësit të tjerë siç ishin inspektorët e tregut dhe të ATK, kanë bërë bastisjen gjegjësisht kontrollin e asaj depo ku gjatë kontrollës kanë gjetur produkte siç janë përshkruar në kallëzimin penal dhe të evidentuara në procesverbal nga inspektorët e tregut të cilat mallra janë konfiskuar nga të njëjtit për procedurë të mëtutjeshme të tyre. Produktet kanë qenë të vendosura në një garazhë e cila ishte përdorur për nevoja të tjera familjare, një pjesë e produkteve ishin jashtë garazhit tek një pjesë tjetër e oborrit. Tutje deklaroi se të njëjtit ma se i kujtohet aty ka pasur mall i cili nuk është sekuestruar e për të cilin është vërtetuar afati i skadencës dhe prejardhja e tyre. Malli në atë depo ka qenë i ekspozuar para shiut dhe se i akuzuari nuk ka pasur deklaramet apo faturat e mallit për prejardhje të tyre. Në depo nuk ka pasur ndonjë tabelë që tregon shitjen e mallit por e njëjta ishte depo ku bëhej ngarkesa me mall dhe

se ky mall ishte shpërndarë në shitore të tjera. Të akuzuarin nuk e ka parë duke shitur mall por e kishte parë një automjet të tipit “Pikap” në oborr e tij të mbushur me mall me afat të skaduar dhe ekskluzivisht për tu shitur. Malli pa afat ka qene në garazh pa asnjë kusht për mirëmbajtjen e tyre.

#### 2.5 Deklarata e dëshmitarit J. S.

Dëshmitari J. S. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me datë 29.10.2020 kanë pranuar informatën që në lagjen “Dardania” në Gjilan në rrugën “Beqir Musliu” ekzistojnë dy depo që dyshohen për shitje të mallrave me afat të skaduar dhe korrigjim e afateve në mallra. Me të pranuar këtë informatë njësia e krimeve ekonomike së bashku me inspektorët komunal të tregut dhe me zyrtarët të ATK-ës kanë realizuar një kontroll në bazë të udhëzimit verbal nga prokurori i çështjes dhe kur kanë shkuar aty kanë kontaktuar edhe pronarin e shtëpisë ku ka qenë prindi i të akuzuarit dhe i njëjti kishte bashkëpunuar me ta dhe më pas kanë kryer kontrollën në dy depot të cilat nuk kane pasur ndonjë mbi shkrim apo llogo të firmës dhe kanë hasur se malli ka qene i renditur në bazë të kushteve që i ofronte lokali, aty në depo nuk kanë gjetur mall me afat të korrigjuar por vetëm me afat të skaduar dhe gjatë kontrollës nuk kanë hasur në ndonjë klient që kishte ardhur për të blerë mall e po ashtu as të akuzuarin nuk e kanë hasur duke shitur mall e po ashtu në lokal nuk kanë hasur në ndonjë makinë për ndërrimin e afatit apo për prodhimin e mallit.

#### 2.6 Mbrojtja e të akuzuarit A. T.

I akuzuari A. T. në mbrojtjen e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se kur myshteri ia kthen një mall ai e paketon dhe të njëjtin e bënë e lë për kthim dhe të njëjtin nuk e lë bashkërisht me mallin i cili ka afat, ai në stok ka shumë pak mall dhe mallin e porosist tek një fabrikë e cila ia sjell mallin në depo dhe ky menjëherë të njëjtin e dërgon në shitore ndërsa në shitore ai shkon e marr porosinë për mall dhe e bënë faturën dhe nëse shitorja ka mall për kthim ai e kthen mallin edhe pse ndodh rrallë, fatura përpilohet në firmën e tij ndërsa mallin blerësit ia dërgon me automjetin e tij të tipi “Pikap”, blerësit e shitoreve zakonisht blejnë mall në shumë prej 7-10 euro ndërsa kur bëhet dorëzimi i mallit edhe ai së bashku me pronarin e shitorës e kontrollojnë se a përshtatet malli i dorëzuar me faturë, atij asnjëherë asnjë blerës nuk i është ankuar se i ka dorëzuar mall pa afat por ka ndodhur që të njëjtit ia kanë kthyer mallin që i ka skaduar afati, po ashtu vet i akuzuari e kontrollon afatin dhe kur e sheh që edhe një javë malli ka afat ai e tërheq mallin nga shitorja dhe këtë mall e merr dhe e pësjell në kuti dhe e lë në garazh në vend të veçantë dhe ia kthen kompanisë furnizuese e cila më pas ia zbaton me mall të ri. Mallin e vitit 2016 e ka marrë nga shitoret për kthim dhe se malli i vitit 2016 atij i është dhimbsur për ta hedhur në bërlllok ndërsa tek prodhuesi nuk ka mundur ta kthej për faktin se deri sa ti vjen malli i ri prodhuesit ai nuk ia ndërron mallin me afat të skaduar prandaj edhe ky mall i është dhimbsur për ta asgjësuar derisa vlera e këtij malli pa afat ka qenë diku rreth 100 euro, policia mallin atij ia kanë gjetur në depo ndërsa në automjetin e tij të markës “Pikap” nuk i është gjetur mall, inspekcioni i tregut atij ia ka kërkuar dokumentacionin për prejardhjen e mallit mirëpo ai nuk ka pasur dokumente për prejardhjen e mallit dhe të njëjtëve nuk i kam ofruar asnjë dokument përveç dokumenteve të firmës, mallin që e shet ai e regjistron në faturën e shitjes, inspekcioni kur ia ka bërë kontrollin nuk i gjetur asnjë faturë në

të cilin ka qenë i shënuar malli me afat të skaduar ndërsa çipsat me afat kanë qenë nën strehë por të paketuara tri herë prej fabrikës dhe në paket shkruan se mallin nuk e prish as i ftohti e as i nxehti, atij asnjë blerës e as qytetar nuk i është ankuar për produktet e tija dhe se i njëjti nuk është prodhues i mallit. Të gjitha mallrat edhe ato me afat të skaduar edhe ato pa afat kanë qenë në një depo- hapësirë të përbashkët mirëpo kanë qenë të ndara, mallin tjetër me afat të cilin e ka pasur në depo nuk ka qenë për shitje mirëpo për shtëpi, mallin që e ka ruajtur nën strehë ka qenë për shitje dhe ai mall ka qenë çipsa, mallin që e ka blerë tek fabrika e ka pasur për ta shitur, mallin që e ka ruajtur nën strehë e ka vendos në qarkullim por i njëjti aty ka qëndruar 3-4 ditë dhe i gjithë malli i cili i është konfiskuar ka qenë mall për kthim dhe ky mall nuk ka qenë për qarkullim dhe se sipas mendimit të tij kthimi i mallit nuk është qarkullim i mallit, ai ka marrëveshje me gojë me prodhuesin dhe me shitoret që mallin e skaduar ta kthejë mirëpo nuk ka marrëveshje me shkrim, ai asnjëherë nuk ka bërë procesverbal për kthimin e sendeve nga shitoret ndërsa me prodhuesit i njëjti e ka regjistruar se çka ka marr dhe çka ka lënë mall dhe se ai nuk ka pasur dokumentacion për mallin pa afat e po ashtu edhe për mallin me afat nuk kam pasur dokumentacion. I njëjti tutje ka deklaruar se ai pronar i firmës 'TosKos', kjo kompani merret me shitblerjen e sendeve ushqimore, ai e lajmëron pronarin e fabrikës prodhuese se ka mall për të kthyer dhe edhe për mallin i cili i është gjetur pa afat ai i ka thirrur të njëjtit dhe të njëjtit i kanë thënë se nuk kanë mall të ri ndërsa kur kanë mall të ri kompanitë furnizuese zakonisht vijnë shpejt por këta për mallin me afat të skaduar nuk kanë ardhë, këta artikuj nuk janë të një prodhuesi të vetëm por të disa prodhuesve, kompania e cila ka bërë kthimin e mallit të vitit 2016 është funksionale mirëpo nuk ka artikuj të tillë nga viti 2018 mirëpo të njëjtit i kanë thënë se do ti sjellin kësi malli dhe për këtë arsye e ai e ka ruajtur mallin, ai e ka regjistruar mallin në librat e tija ndërsa këto libra nuk ia ka treguar inspektorëve të tregut sepse të njëjtit ia kanë kërkuar vetëm faturat e mallit gjithashtu edhe për mallin me afat i kishte faturat por në ato momente ishte humb dhe të njëjtëve nuk ua kishte treguar ndërsa për mallin pa afat nuk kam pasur fatura fare.

### 3. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale, gjykata komfor nenit 7, 361 dhe 362 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të njëjtit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara me ç'rast gjykata ka ardhur në përfundim se mbrojtjes së të akuzuarit të dhënë në shqyrtim gjyqësor nuk duhet ti falet besimi ngase një mbrojtje e tillë nuk është në harmoni me provat e tjera personale dhe materiale të cilat janë administruar nga ana e gjykatës dhe të cilat tregojnë një gjendje faktike tjetër nga ajo për të cilën i akuzuari ka pretenduar ndërsa në anën tjetër gjykata ia fali besimin e plotë deklaratave të dëshmitarëve përkatësisht inspektorëve të tregut A. F. dhe G. S. si dhe dëshmitarëve-zyrtarëve policor Sh. S., A. K. dhe J. S. të cilët treguan ngjarjen në mënyrë të njëjtë dhe se deklaratimet e tyre janë në harmoni të plotë edhe me provat materiale të administruara nga ana e gjykatës.



Pas administrimit të provave personale dhe materiale gjykata gjeti se në këtë çështje penalo juridike nuk ishte kontestues fakti se i akuzuari A. T. është pronar i firmës “TasKos”, me seli në Gjilan dhe se kjo firmë merret me tregti me pakicë në dyqane jo të specializuara ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani sepse këto fakte janë vërtetuar përveç deklarimit të vet të akuzuarit po ashtu edhe nga prova materiale e administruar nga ana e gjykatës dhe atë të dhënat nga ARBK-ja në të cilat konstatohet se pronar i firmës “TasKos”, me seli në Gjilan është i akuzuari dhe se përshkrimi primar i kësaj firmë është tregtia e pakicë në dyqane jo të specializuar ku mbizotëron ushqimi pijet dhe duhani, po ashtu nuk ishte kontestuese se zyrtarët policor së bashku me inspektorët e tregut dhe zyrtarët e ATK-ës pas marrjes së informatës se në firmën e të akuzuarit është duke u bërë shitja e mallrave pa afat kanë shkuar në firmën e tij dhe kanë bërë kontrollin e saj dhe aty kanë gjetur mallra të cilat ishin me afat të skaduar dhe mallra të cilat ruheshin në kushte të papërshtatshme e të cilat më pas janë sekuestruar dhe shkatërruar nga ana inspektorëve të tregut e për të cilat mallra i akuzuari para inspektorëve të tregut nuk kishte paraqitur asnjë dokument mbi prejardhjen e këtij malli apo çfarëdo dokumenti tjetër lidhur me origjinën e tij sepse këto fakte vërtetohen nga dëshmitë e dëshmitarëve A. F., G. S., Sh. S., A. K. dhe J. S. të cilat dëshmi kanë lidhshmëri logjike, kohore, janë bindëse, të qarta dhe janë në harmoni të plotë me njëra tjetrën si dhe gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi po ashtu këto fakte vërtetohen edhe nga provat materiale dhe atë raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2020-KE-133 i datës 29.10.2020, procesverbali mbi kontrollin e lokalit i datës 26.10.2020, procesverbalet mbi inspektimin të bëra nga Drejtoria e Inspekcioni përkatësisht Inspekcioni i Tregut me numër 14/1054 i datës 29.10.2020 dhe numra serik 001052, 001053 dhe 001054, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, të dhënat nga ARBK për kompaninë NTP “TosKos”, raporti i hetuesit i datë 29.10.2020.

Bazuar në të lartcekurat gjykata gjeti se në këtë çështje penalo juridike kontestuese ishte fakti nëse i akuzuari mallin me afat të skaduar e kishte për ta shitur si dhe fakti nëse malli tjetër me afat ishte duke u ruajtur në kushtet e parapara sipas prodhuesve por gjykata këto fakte i zgjidhi duke u bazuar së pari në deklaratën e dëshmitares A. F. e cila njëherit është edhe inspektore e tregut në seancën e shqyrtimit ka deklaruar se *“Prodhuesi i përcakton kushtet e ruajtjes së produktit ndërsa këto mallra nuk janë ruajtur në kushte të përshtatshme sepse nuk është dashur të ruhen në ambient të jashtëm ngase përveç temperaturave të njëjtat rrezikohen edhe nga brejtësit dhe nga gjerat e tjera”* dhe se *“Mallin e sekuestruar e kanë gjetur gjet në një vend të cilin nuk do ta kishte quajtur depo por garazh dhe oborr”*, *“...garazhi ka pasur mbulojë për ta ruajtur mallin nga shiu, breshëri, drita dhe dielli mirëpo garazhi nuk është i përcaktuar për vendosjen e mallit kurse në depo ushqimore janë kushte tjera të përcaktuara me ligjin mbi ushqimin”*, po ashtu në harmoni të plotë me të lartcekurat është edhe dëshmia e dëshmitares G. S. e cila po ashtu është edhe inspektore e tregut e cila kishte deklaruar se *“...pastaj kishte ardhur i akuzuari e kishte hapur garazhin dhe brenda kishte pasur mall pa afat siç ishin produkte ushqimore për fëmijë, në oborr kishte pasur mall me afat i cili nuk ishte ruajtur sipas kushteve të ruajtjes të cilat i përcakton ligji për ushqimin sepse i njëjti mall ishte në ambient të*

*hapur, biznesi i të akuzuarit është i regjistruar dhe bazuar në këtë malli i gjetur tek ai ka qenë i dedikuar për shitje, në garazh ka pasur mallra që në vitin 2016 iu kishte skaduar afati dhe si të tilla nëse të njëjtat shiten apo konsumohen janë të dëmshme për shëndetin e njeriut, malli i gjetur në ambient të hapur-oborrit e të akuzuarit në kushtet të cilat ka qenë edhe ai ka përbërë rrezik për shëndetin e njeriut sepse çdo prodhues i mallit përcakton kushtet e ruajtjes së tij, të cilat kushte janë të shkruara në etiketat të bashkangjitura në ambalazh. Në Ligjin për Ushqimin përkatësisht në nenin 20 pika 4.5, 4.6, 4.7 përcaktohen kushtet për ruajtjen e ushqimit dhe në rastin konkret malli i gjetur tek i akuzuari ka qenë në kundërshtim me këtë ligj”.*

Po ashtu fakti se i akuzuari ka poseduar mall me afat të skaduar, mallin e tij e ka ruajtur në kushte të papërshtatshme dhe të njejtin e ka pasur me qëllim të shitjes është vërtetuar edhe nga deklarata e dëshmitarit Sh. S. i cili kishte deklaruar “ ....tek një lloj i magazinës e cila ishte shfrytëzuar si depo dhe në të cilën kanë hasur disa artikuj të ndryshëm ushqimor dhe higjienik të cilat sipas inspekcioni komunal dhe njësisë sonë kanë qenë me afat të skaduar gjë që argumentohet edhe në bazë të procesverbalit nga inspektorët komunal, njëkohësisht nga inspektorët edhe ATK-ja kanë hasur në mallra që nuk kanë pasur dokumentacion mbi prejardhjen e tyre,.....malli në depo ka qenë i renditur por kjo depo ka qenë garazh dhe nuk ka qenë e destinuar për depo sepse aty ka pasur edhe vegla të punës dhe sende të tjera dhe se të akuzuarin e kanë zënë në flagrancë duke shpërndarë mall”, deklarim ky i cili është në harmoni të plotë edhe me deklaratën e dëshmitarit A. K. i cili ka deklaruar se “Produktet kanë qenë të vendosura në një garazhë e cila ishte përdorur për nevoja të tjera familjare, një pjesë e produkteve ishin jashtë garazhit tek një pjesë tjetër e oborrit. Malli në atë depo ka qenë i ekspozuar para shiut dhe se i akuzuari nuk ka pasur deklaratimet apo faturat e mallit për prejardhje të tyre. Në depo nuk ka pasur ndonjë tabelë që tregon shitjen e mallit por e njëjta ishte depo ku bëhej ngarkesa me mall.... dhe se të akuzuarin nuk e ka parë duke shitur mall por e kishte parë një automjet të tipit “Pikap” në oborr e tij të mbushur me mall me afat të skaduar dhe ekskluzivisht për tu shitur”. Të lartcekurat po ashtu vërtetohen edhe nga dëshmia e dëshmitarit J. S. i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor kishte deklaruar se “aty në depo nuk kanë gjetur mall me afat të korrigjuar por vetëm me afat të skaduar”.

Andaj bazuar në të lartcekurat dhe atë se veprimet me të cilat kryhet kjo vepër penale janë paraqitur në formë alternative dhe kanë të bëjnë me prodhimin me qëllim shitje, shitjen, ofrimi për shitje dhe vënien në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër të artikujve ushqimor, pijeve apo prodhimeve të tjera të dëmshme për shëndetin e njeriut e që kryerësi e di se janë të dëmshme, faktin se ofrimi për shitje është veprimi me të cilin një apo shumë personave të caktuar apo të pa caktuar u bëhet me dije mundësia e shitjes së artikujve ushqimor, pijeve ose sendeve tjera të dëmshme për shëndetin e njeriut, p.sh. reklamimi, ekspozimi si dhe faktin se pasoja e veprës është rreziku abstrakt për shëndetin e njeriut dhe se vepra konsiderohet se është kryer nëse ndërmerret ndonjë veprim me të cilin kryhet kjo vepër penale gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formësohen të gjitha elemente e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor për faktin se i njejtin e ka ditur se artikujt ushqimor me afat të skaduar janë të dëmshëm për shëndetin e njeriut, po ashtu i njejtin e ka ditur se ekspozimi i tyre në depo është i ndaluar dhe përkundër kësaj i njejtin mallrat me afat dhe ato me afat të skaduar i ka mbajtur

brenda depon së tij ku e bënte shitjen e mallit dhe mbi të gjitha malli i sekuestruar tek i njëjti ishte me afat të skaduar duke filluar nga viti 2016 e deri në vitin 2020.

Gjykata po ashtu ka analizuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit A. T. dhe erdhi në përfundim se mbrojtjes së tij nuk duhet ti falet besimi e gjitha kjo për faktin se i akuzuari në mbrojtjen e tij nuk e ka mohuar në asnjë stad të procedurës penale se malli i gjetur tek ai i përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ka qenë me afat të skaduar por se këtë mall nuk e kishte pasur për ta shitur por e kishte pasur për ta kthyer tek furnitorët por një mbrojtje e tillë ishte në kundërshtim të plotë me gjitha provat personale dhe materiale të administruara nga ana e gjykatës dhe se e njëjta nuk kishte lidhshmëri logjike, kohore dhe ishte e pa qartë në raport me provat e tjera ngase në mbrojtjen e tij i akuzuari ka deklaruar se *“Mallin e vitit 2016 e kemi marrë nga shitoret për kthim, këtë mall e kemi marrë ndoshta në vitin 2017 ose 2018, kur mallit i skadon afati këtë mall vjen fabrika prodhuese për ta marr, këtë mall të vitit 2016 mua më është dhimbsur për me qit ne bërlllok ndërsa tek prodhuesi nuk kemi mundur me kthye për faktin se deri sa ti vjen malli i ri prodhuesit”* dhe se *“unë e lajmëroj pronarin e fabrikës prodhuese se kam mall për të kthyer, edhe për mallin i cili më është gjetur pa afat unë i ka thirrur të njëjtit dhe të njëjtit më kanë thënë nuk kanë mall të ri, ndërsa kur kanë mall te ri zakonisht vijnë shpejt por këta nuk kanë ardhë”, “kompania e cila ka bërë kthimin e mallit të vitit 2016 është funksionale mirëpo nuk ka artikuj të tillë më që nga viti 2018 më duket, mirëpo të njëjtit më kanë thënë se do të sjellin kësi malli dhe për këtë arsye e kam ruajtur mallin”* çka nënkupton se furnitorët sipas të akuzuarit zakonisht vijnë shpejt për ta bërë kthimin e mallit por në rastin konkret ata as pas 4 viteve nuk kanë ardhur për ta bërë një gjë të tillë edhe pse për të njëjtit i akuzuari e dinte se që nga viti 2018 ata nuk punojnë me produktet të tilla por përsëri i produktet me afat të skaduar i ka mbajtur në depon e tij ku edhe e bënte shitjen e mallin deri kur të njëjtit i ishte bërë kontrolli nga ana e Inspektorëve të Tregut i cili mall më pas nga ana e tyre ishte sekuestruar dhe shkatërruar sepse paraqiste rrezik për shëndetin e njeriut.

Sa i përket refuzimit të propozimit të mbrojtjes për dëgjimin e dëshmitarit K. A. gjykata një vendim të tillë e mori për faktin se ky dëshmitar nuk kishte të bënte asgjë me të provuarit e gjendjes faktike për veprën penale e cila i vihej në barrë të akuzuarit por i njëjti ishte propozuar me qëllim të shpjegimit të rrethanave të bashkëpunimit në mes kompanisë së këtij dhe kompanisë së të akuzuarit shtu këtu faktin se edhe malli i cili është gjetur tek i akuzuari ishte me aftat të skaduar duke përfshirë periudhën kohore nga viti 2016 deri në vitin 2020 dhe ishte e pa kuptueshme se si mund të kalojnë 4 vite për kthimin e një malli pavarësisht marrëveshjeve verbale mes kompanive të tyre.

#### 4.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata erdhi në përfundim që është vërtetuar plotësisht gjendja faktike si dhe është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se e akuzuari A. T. ka kryer veprën prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimor nga neni 261 paragrafi 1 i KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## 5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesës si dhe përgjegjësinë penale të saj, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit e cila nga provat materiale në shkresat e lëndës del të jetë e lartë meqenëse me rastin e kryerjes së veprës penale i njejtë ka qenë i përgjegjshëm për veprimet e tija dhe se veprën penale e ka kryer me dashje dhe atë direkte, me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh edhe rrethanat personale të kryesit si dhe sjelljen e mëparshme të tij.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata mori sjelljen e mëparshme të tij meqenëse për të akuzuarën ishte hera e parë që bie ndesh me ligjin përkatësisht i njejtë më parë nuk kishte qenë e gjykuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për asnjë lloj të veprës penale po ashtu gjykata si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata mori edhe rrethanat personale të tij dhe karakterin e tij ngase nga provat e administruara del se i akuzuari është i martuar, kurrë më herët nuk ka rënë ndesh me ligjin rrethana këto që tregojnë për karakterin e të akuzuarit ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarën gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të akuzuarit meqenëse i njejtë veprën penale e ka kryer me dashje dhe atë direkte duke qenë e vetëdijshme se mallrat me afat të skaduar përveç që nuk guxojnë të shiten ato nuk guxojnë as të mbahen në depo së bashku me mallrat e tjera të ekspozuara për shitje sepse të njëjtat ishin pa afat duke filluar nga viti 2016 e deri në vitin 2020 andaj duke u bazuar në të lartcekur gjykata të akuzuarit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 72 të KPRK-ës gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj tij mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë gjykata mori parasysh edhe gjendjen ekonomike të akuzuarit e cila sipas tij del të jetë e mesme dhe rrjedhimisht gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar si më lartë të njëjtit por as anëtarëve të tjerë të familjes së saj nuk i rrezikohet mirëqenia ekonomike.

## 6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuarit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarën ta obligojë që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.903/2020, me datë 17.06.2021

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica  
Sermaxhaj

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.